

MARENGLIEN VERLI

**QËNDRIME NË HISTORIOGRAFINË DHE PUBLICISTIKËN
SERBE E JUGOSLLAVE TË VITEVE 80-TË PËR DISA
MOMENTE TË HISTORISË SË POPULLIT SHQIPTAR***

Për momentet më kyçe të historisë së popullit shqiptar lidhur me origjinën e tij të hershme, autoktoninë, shtrirjen territoriale në rajon në periudha të ndryshme historike, nivelin e civilizimit, mandej për raportet shqiptaro-serbe gjatë shekujve, për politikën e Serbisë ndaj shqiptarëve gjatë shekullit të XIX dhe fillimit të shekullit XX, për synimet e Serbisë e më pas të Jugosllavisë ndaj Shqipërisë gjatë shek. XX etj., historiografia serbe, që në fillimet e veta e më pas edhe ajo jugosllave si përfaqësues të historiografisë maqedonase, përgjithësisht janë prononcuar nga pozita jo objektive¹.

Duke mos u fokusuar posaçërisht për probleme të historisë, që i përkasin periudhave para shek.XX apo periudhave para historisë bashkëkohore, do t'ia vlen të cekej se historiografia në fjalë, gjatë trajtimit të periudhave të hershme historike, duke përjashtuar raste autorësh me origjinë joserbe të periudhës së Pasluftës së Dytë Botërore si: A. Stipçeviq, R. Katiçiq, apo H. Bariq², ka mohuar përkatësinë ilire të dardanëve që banonin Kosovën e më gjerë në antikitet dhe, rrjedhimisht, edhe autoktoninë e shqiptarëve. Ajo i ka konsideruar arbrit të ardhur në Ballkan ose të formuar aty nga mbeturina popujsh, pasi sllavët ishin vendosur në këtë gadishull dhe kishin krijuar formacionet e tyre shtetërore. Natyrisht këta arbër-shqiptarë, sipas tezave jo shkencore të sipërpërmendura, do të duhej të banonin në një territor relativisht të kufizuar, i cili madje qenkësh zgjeruar në dëm të viseve sllave gjatë shekujve XII-XIV për shkak të shtrirjes së sundimit të despotëve serbë dhe, sidomos, gjatë periudhës

* Kumtesë e mbajtur në *Seminarin III Ndërkombëtar të Albanologjisë*, organizuar në Shkup, më 23-27 shtator 2009, nga Universiteti Shtetëror i Tetovës.

¹ Shih *Enciklopedia e Maqedonisë*, Shkup, 2009.

² Aleksandër Stipçeviq, "Çdo tregim për Ballkanin fillon me ilirët", në vëll. *E vërteta për Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi*, f.59; Radosllav Katiçiq, "Antroponimia ilire dhe etnogjeneza e shqiptarëve", kumtesë e mbajtur në *Kuvendin e II të Studimeve Ilire* (Tiranë 1972), botuar në materialet e këtij Kuvendi, Tiranë, 1974, f. 95-98; Henrik Bariq, *Hymje në historinë e gjuhës shqipe*, Prishtinë: 1955, f. 47-50. Ndër autorët më të hershëm mund të shihet Millan Shuflai, *Serbët dhe shqiptarët*, Prishtinë: 1968.

së sundimit osman, për shkak të integritit dhe të kauzës së përbashkët të shqiptarëve me turqit gjatë pesë shekujve³. Vlerësimi i arbërve-shqiptarëve si një popullsi primitive, kryesisht baritore, nomade, mandej mercenare e pa vlera shtetformuese, e cila kish zgjeruar territorin e banimit duke zbritur nga malet në mënyrë të dhunshme ose që ishte shtrirë drejt lindjes duke përfituar nga spastrimi etnik i viseve serbe për shkak të shpërnguljeve masive në rrethana specifike historike në shek. XVII-XVIII dhe më vonë në shek. XIX-XX⁴, si edhe teza të tjera të ngjashme, kanë pasqyruar kështu shërbimin që pseudoshkenca serbe i ka bërë elitës politike të Serbisë, planet ekspansioniste të së cilës janë të njohura, madje edhe përmes projekteve të shumta që zënë fill nga “Naçertania” e Ilia Garashaninit e vitit 1844 e deri te “Promemoria” famëkeqe e akademikëve serbë e vitit 1986⁵.

Në frymën e sipërpërmendur historiografia serbe, e me sa duket jo vetëm ajo, ka trajtuar të deformuara marrëdhëniet shqiptaro-serbe, e përgjithësisht shqiptaro-sllave gjatë shekujve, duke devijuar nga e vërteta për raportet e ndërsjellta, duke sfumuar apo fokusuar posaçërisht, ose keqinterpretuar sipas rastit, raportet e bashkëpunimit dhe të konfrontimit etj. Duke ecur kësaj traseje, historiografia serbe ka atakuar e deformuar edhe historinë e shtetit shqiptar, të zhvillimit të tij, të elitës së tij politike, të komuniteteve të tij fetare etj.⁶

Qëndrime të tilla në historiografinë dhe publicistikën historike serbe, si edhe te autorë të tjerë sllavë nga vise të ndryshme të Jugosllavisë jo vetëm në të kaluarën e largët apo më të afërt, por edhe në vitet 80-të të shek.XX, në dekadën e fundit të ekzistencës së Federatës Jugosllave⁷, (madje edhe sot e kësaj dite), të cilat u përsëritën fort në një kohë kur Kosova ishte një krahinë autonome me status mjaft të avancuar në Federatën Jugosllave (Me Kushtetutën e vitit 1974 KSA e Kosovës konsiderohej element konstituiv i Federatës), dhe kur në kuadër të ndryshimeve të pritshme pas vdekjes së Titos po artikulonte gjithnjë e më fort kërkesën për t’u njohur si republikë, qëndrime të tilla pra, shkonin sinkron me politikën e qarqeve drejtuese të Serbisë, por dhe të segmenteve të caktuara të elitave politike në republikat e tjera të pozicionuara

³ Shih: *Kosovo-Past and Present*, Belgrade: 1989; Shih autorët Sima Qirkoviq dhe Milutin Garashaninin.

⁴ *Po aty*, shih autorët Atanasia Urosheviq, Bogumil Hrabak, Milija Shçepanoviq, Ruzha Petroviciq dhe Marija Bllagojeviciq etj.

⁵ *Delo*, K. 38, Beograd 1906, f. 321-333. Përkthimi sipas H. Bajramit, botuar në *Vjetar-Godisnjak*, XXIV/88, Prishtinë: 1988; Shih edhe M. Verli, *Kosova – sfida shqiptare në historinë e një shekulli*, Tiranë: 2007, f. 29-42; *Po aty*, f. 335-342. Pjesë nga Memorandumi i Akademisë së Shkencave dhe Arteve, Beograd, 1986.

⁶ *Po aty*, shih autorët: Spasoje Gjakoviq, Desanka Peshiq; Janko Pleterski; Branko Petranoviq, Blagoje Nikoliq, Milosh Mishoviq etj.

⁷ *Kosovo-Past and...;* Shih edhe: *Memorandumi i Akademisë së Shkencave dhe Arteve*, Beograd: 1986.

njësoj për motive të ndryshme. Këto parqe kërkonin argumente të çdo lloji jo vetëm për të penguar procesin e sipërpërmendur të avancimit të merituar të pozitës së shqiptarëve, por, madje, në të kundërt për të reduktuar autonominë e Kosovës, për të ruajtur përparësinë politike dhe ekonomike të pakicës serbo-malazeze në Kosovë dhe për të rikrijuar të paktën “Serbinë e Madhe” të kohëve të reja, nëse nuk do të mund të sigurohej dominimi i Serbisë në Jugosllavinë Federative.

Në memorandumun e sipërpërmendur të Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve të vitit 1986, u vu si asnjëherë më parë në korniza “shkencore” fjalori politik i qarqeve ekstremiste serbe, që në emër të unifikimit të Serbisë dhe nën pretextin e ndalimit të të ashtuquajturit “persekutim të vazhdueshëm të serbëve në Kosovë”, kërkonte anulimin me çdo mjet të autonomisë së KSA të Kosovës, duke kërcënuar në të kundërt me “destabilitet të plotë të Jugosllavisë”. Sipas akademikëve serbë, aktualisht “gjenocidi fizik, politik, juridik dhe kulturor mbi popullin serb të Kosovës e Metohisë, ishte disfata më e rëndë në luftërat nacionalçlirimtare që kishte zhvilluar Serbia nga Orosi më 1804 deri në kryengritjen e vitit 1941”. Sipas tyre “popullit serb i ishte shpallur një luftë e vërtetë speciale, e hapur dhe totale”, “dëshmi spektakolare” e së cilës ishte “dëbimi i popullit serb” nga “mëmëdheu i ekzistencës së vet historike”. Sipas akademikëve, nëse shpërnguljet qysh nga viti i “shpërnguljes së madhe” të vitit 1690 e deri më 1912 i kishin kushtuar popullit serb 500 mijë të shpërngulur nga Kosova dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore edhe 60 mijë kolonë të larguar, vetëm gjatë 20 vjetëve të fundit (1966-1986) humbjet e kësaj natyre llogariteshin në rreth 200 mijë serbë e malazezë. Për “shqiptarizimin” e Kosovës në memorandum fajësoheshin strukturat drejtuese të Federatës dhe mefshtësia e elitës politike të Serbisë së pasluftës botërore, të cilat i kishin lënë hapësirë “përfaqësuesve zyrtarë të Krahinës, si edhe shkencëtarëve të saj, të sillëshin jo vetëm në mënyrë arrogante, por edhe cinike”, për të shpifur e shantazhuar në të mirë “të nacionalizmit agresiv shqiptar”, që vepronte në bashkëpunim dhe “sipas instruksioneve nga Tirana në mënyrë plotësisht të hapur”.

Duke artikuluar disa herë radhazi idenë e skajit ekstrem të elitës politike të Serbisë për veprime drastike, që duhet të çonin fillimisht në asgjësimin e autonomisë së Kosovës, e pastaj edhe në hapa të tjerë ndaj republikave dhe kombeve e kombësive të tjera të Federatës Jugosllave, akademikët serbë shkruanin në vitin 1986 se “nacionalizmi agresiv shqiptar në Kosovë, nuk mund të mposhtej në qoftë se Serbia nuk pushonte së qeni republika e vetme, marrëdhëniet e brendshme të së cilës i rregullonin të tjerët”. Gjendja ekzistuese e Serbisë, theksonin ata së fundi “kërkonte në mënyrë imperative reforma rrënjësore...” për çka shpreheshin të gatshëm të kontribuonin “në mënyrë të gjithanshme dhe me tërë forcat...”

Në kontekstin e sipërpërmendur dhe në frymën e memorandumit të vitit 1986, në vitin 1989 në Beograd u përgatit nën kujdesin e një grupi tejet të politizuar⁸ dhe u botua në gjuhët angleze dhe serbe një vëllim prej disa qindra faqesh me shkrimet apo artikujt e 29 autorëve, i titulluar “Kosovo-Past and Present” (Kosova- e kaluara dhe e tashmja). Ky libër pasonte dhjetra monografi të botuara vetëm në vitet 80 me tema të ndryshme për historinë e Kosovës dhe të Shqipërisë⁹.

Në këtë vëllim, që sintetizonte frymën dhe tezat e deriatëhershme të historiografisë serbe për historinë e popullit shqiptar, autorë, si S. Qirkoviç e M. Garashanin, neglizhonin ose kundërshtonin tezat dhe argumentet e historiografisë shqiptare, njëherësh teza e argumente mbizotëruese edhe në historiografinë evropiane dhe përsërisnin tezat që mohonin vazhdimësinë etnike iliro-shqiptare, nga antikiteti në Mesjetë, gjithashtu përkatësinë ilire të dardanëve dhe praninë e tyre në Kosovë në kohën e vendosjes së sllavëve¹⁰.

Autorët e sipërpërmendur në tentativën për të vlerësuar praninë e tyre shumë të pakët e kryesisht baritore e nomade, në periudhën paraosmane,

⁸ Milutin Milenkoviç, ish-drejtor i Radio-Beogradit, Milosh Mishoviç, gazetar dhe Milorad Komatina - ambasador në pension.

⁹ Dimitrije Bogdanoviç, *Knjiga o Kosovu*, Belgrade: 1985; Po ai, *Razgovori o Kosovu*, Belgrade: 1986; A.N. Dragniq, S. Todoroviç, *The saga of Kosovo, Fokus on Serbian-Albanian Relations*, New York: 1984; S. Gjakoviç, *Sukobi na Kosovu*, Belgrade: 1984; A. Urosheviç, *Kosovo*, Beograd: 1965; etj.

¹⁰ *Historia e Shqipërisë*, vëll. I, Tiranë: 1964; *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Tiranë: 1985, Aleks Buda, *Shkrime historike*, vëll. I, II, Tiranë: 1986; Nicolae Jorga, *Breve histoire d'Albanie et des Albanais*, Bucarest: 1919; Selami Pulaha, *Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shek. XV-XVI* (Studime e dokumente), Tiranë: 1984; Po ai, *Pronësia feudale në tokat shqiptare (shek. XV-XVI)*, Tiranë: 1988; Milan Suflai, “Iz Istorije severnih albanaca”, në: *Starine II*, 1924; *Shqiptarët dhe trojet e tyre*, Tiranë: 1982; Muhamet Tërnavë, *Popullsia e Kosovës gjatë shek. XIV-XVI*, Prishtinë: 1995; Injac Zamputi, *Dokumente të shek. XV për historinë e Shqipërisë*, IV, Pjesa I, Tiranë: 1967, Pjesa II, Tiranë: 1979; Koço Bozhori, *Dokumente bizantine për historinë e Shqipërisë*, Tiranë: 1978; Koço Bozhori, Filip Liço, *Burime dokumentare bizantine për historinë e Shqipërisë*, Tiranë: 1975; Aleks Buda, Injac Zamputi, Kristo Frashëri, Petraq Pepo, *Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë, II, shek. VII-XV*, Tiranë: 1962; Shaban Demiraj, *Prejardhja e shqiptarëve në dritën e dëshmime të gjuhës shqipe*, Tiranë: 1999; Konferenca Kombëtare për Formimin e Popullit Shqiptar, të Gjuhës e Kulturës së tij (Tiranë 2-5 korrik 1982), Tiranë, 1988 etj.; Sima Qirkoviç, “Djepi i Serbisë”, në vëllimin *Kosova pas and....*; Milutin Garashanin, “Ilirët dhe shqiptarët”, *po aty*; S. Qirkoviç (1929), profesor në Fakultetin e Filozofisë të Universitetit të Beogradit dhe anëtar i Akademisë së Arteve dhe Shkencave të Serbisë, anëtar i akademive të disa republikave të RSFJ, si edhe anëtar i Akademisë Evropiane për historinë në Bruksel. M. Garashanin (1920) profesor në pension i Fakultetit të Filozofisë të Universitetit të Beogradit dhe anëtar i Akademisë së ASHS dhe anëtar korrespondent i AASH të B-H.

objektet fetare të krishtera në Kosovë i tregonin si dëshmi të pranisë të popullsisë serbe atje, pavarësisht se ishte i njohur dhe i argumentuar fakti se krishterimi kishte rrënjë në popullsinë parasllave të rajonit, madje fillimisht kishte pësuar edhe persekutimin ose dhunën e sllavëve të ardhur paganë¹¹. M.Garashanini shkoi deri aty sa jo vetëm të mohonte vazhdimësinë iliro-shqiptare, por të vinte në dyshim edhe praninë e të njëjtit element etnik nën emërtimet arbër dhe shqiptar dhe të mohonte çdo prani të shqiptarëve në Kosovë e më gjerë, në fillim të mijëvjeçarit të dytë. Lëvizja e vetme e M.Garashaninit nga teza të konsumuara më herët është se ai pranoi të konsiderojë shqiptarët jo të ardhur në Ballkan nga jashtë gadishullit, por pasardhës të “mbeturinave të një popullsie paleobalkanike jo të romanizuar”, të rajoneve ku “ka pasur edhe mbeturina të ilirëve dhe dardanëve”. “Këta elementë me origjinë të ndryshme, sipas Garashaninit, për shkak të mënyrës së tyre nomade të jetesës u integruan dhe hynë në histori si një popull i ri vetëm në shekujt XI dhe XII”¹².

Gjithnjë në kontekstin e sipërpërmendur autorëve si Urosheviq e Hrabak do t'u duhej të arsyetonin praninë e shumë të shqiptarëve në Kosovë dhe praninë e pakët të serbëve, me dhunime e shpërngulje të herëpashershme të tyre. Keqinterpretimet për këto procese fillimisht kanë kulmuar me paraqitjen e procesit të shpërnguljes së popullsisë së Kosovës drejt veriut ose territoreve të Austrisë, gjatë dhe pas tërheqjes së ushtrisë austriake, në dekadën e fundit të shek. XVII, nën drejtimin e Patrikut Arsenije Černojeviq, si “shpërngulje e madhe e serbëve”. Njëherësh, në mënyrë abuzive, prania masive e shqiptarëve aty është argumentuar me vërshimin e shqiptarëve nga malet në perëndim të Kosovës, edhe pse dokumentacioni i kohës nuk lë shteg për realitetin e situatës etnike në Kosovë e më gjerë, para dhe pas ngjarjes së përmendur. Prania e pakët e serbëve në Kosovë argumentohet nga autorët serbë edhe me silueta të ngjashme të mëvonshme, realisht mjaft të dokumentuara por gjithnjë të keqinterpretuara. Kështu p.sh. pretendohet për largim masiv të serbëve në dekadat e fundit të shek.XIX, pas luftërave serbo-turke e ruso-turke të viteve 1877-1878 dhe pas aneksimit nga Serbia të Sanxhakut të Nishit, që u shoqërua me dyndjen (në fakt dëbimin) e dhjetra mijë shqiptarëve prej andej drejt Kosovës për shkak të dhunës së shqiptarëve të mellfosur etj.¹³

¹¹ *Po aty.*

¹² *Po aty.*

¹³ Atanasie Urosheviq, “Proceset etnike në Kosovë gjatë sundimit turk”, në vëllimin *Kosova past and...*; Bogumil Hrabak, “Lidhja e Prizrenit dhe shqiptarët e Kosovës dhe Metohisë nga Lidhja e Prizrenit deri në vitin 1918”, *po aty*, A. Urosheviq (1898) profesor në pension i Fakultetit të Matematikës dhe të Shkencave Natyrore të Universitetit të Shkupit. Anëtar i A.A.SH të Serbisë; B. Hrabak, (1927), profesor i Fakultetit të Filozofisë në Novi Sad, anëtar i ASHA të Kosovës.

Gjithnjë në të njëjtin kontekst D.Peshiq dhe N.Gaçesha trajtuan nga një këndvështrim i paracaktuar situatën dhe problemet në Kosovë në periudhën midis dy Luftërave Botërore¹⁴.

D. Peshiq kolonizimin serbo-sllav të Kosovës e më gjerë e konsideron “rikthim” të serbëve në “djepin” e tyre historik. Kjo autore nënvizon gjithashtu vlerën ekonomike e sociale të procesit kurse ato çka u ndodhën shqiptarëve, përkatësisht shpronësimi me dhunë nga pronat e tyre private dhe kolektive, si edhe shpërngulja pa kthim, edhe pse është pohuar hapur nga instancat zyrtare kompetente të Serbisë e Jugosllavisë gjatë gjithë shek.XX se kanë qenë procese të një goditje politike të llogaritur me gjakftohtësi¹⁵, sipas saj ishin vetëm disa “gjëra të papëlqyera”¹⁶. Në këtë rrjedhë arsytimi për Desankën qëndrimi i PK Jugosllave në vitin 1940 për largimin e kolonëve nga Kosova, ishte i gabuar dhe pasojë të diktatit të Kominternit dhe PK BRSS. Kështu, ndonëse jo në tematikën e profilizimit të saj, kjo autore, i bashkohej korit shumicë në historiografinë serbe-jugosllave që e konsideronte Kosovën tokë serbe dhe, me argumentin e të drejtës historike të serbëve mbi Kosovën, arsytonte politikën e spastrimit etnik të ndjekur atje tradicionalisht nga Beogradi zyrtar kundër shumicës shqiptare.

Në të njëjtën kudhër rreh edhe avokati M.Shçepanoviq, i cili është bërë bashkautor në vëllimin përmbledhës të përmendur, i sprovuar vetëm me disa

¹⁴ Desankia Peshiq, “Partia Komuniste e Jugosllavisë dhe çështja kombëtare e shqiptarëve midis dy luftërave botërore”, në vëllimin *Kosova- past and.....*; Nikolla Gaçesha, “Vendndodhja e Kosovës dhe Metohisë pas Luftës së Parë Botërore dhe reforma agrare”, *po aty*, D.Peshiq (1927), drejtoreshë e Institutit të Historisë të Lëvizjes Punëtore të Serbisë. Vepër e botuar: *Komunistët jugosllavë dhe çështja nacionale (1919-1935)*; N.L. Gaçesha (1924), profesor në Universitetin e Novi Sadit dhe bashkëpunëtor në Institutin e Historisë në Fakultetin e Filozofisë të Universitetit të Novi Sadit: Vepër të botuara: *Reforma agrare dhe kolonizimi në Banat 1919-1941*, *Reforma agrare dhe kolonizimi në Srem* (1975), *Reforma agrare dhe kolonizimi në Jugosllavi 1945-1948* (1984).

Për argumentet e historiografisë shqiptare shih *Historinë e Shqipërisë*, vëll.I, Tiranë: 1959; *Historinë e Shqipërisë*, vëll. II, Tiranë: 1984; *Fjalorin Enciklopedik Shqiptar*, Tiranë: 1985; si edhe autorët e përmendur A. Buda, S. Pulaha etj. gjithashtu K. Frashëri, S. Pollo etj. dhe vëllimet me dokumente: *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare (1878-1912)*, Tiranë: 1978; *Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878-1881) në dokumente angleze*, Prishtinë: 1978; *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet osmane (1878-1981)*, Tiranë: 1978, *Salnametë e vilajeteve të Kosovës, Manastirit, Janinës etj.*

¹⁵ Shih Gjorgje Krstiq, *Kolonizacija na Juzhnoj*, Sarajevo: 1928; Milovan Obradoviq, *Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu*, Prishtinë: 1981; *Kosova nekad i danas – Kosova dikur dhe sot*, Beograd: 1973; etj.

¹⁶ *Po aty*.

artikuj të botuar më parë për Kosovën¹⁷. Avokati bën një përmbledhje të shpërnguljes së serbëve nga Kosova në periudhën 1878-1988, të deformuar në atë mënyrë që të arsyetojë çdo veprim a dhunë gjatë shek.XX mbi shqiptarët për riserbizimin e Kosovës. Sipas tij shqiptarët i dhunuan serbët në Kosovë në vitet pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit deri më 1912, i dhunuan sërisht gjatë viteve 1916-1918 të Luftës së Parë Botërore, përsëri në vitet 1941-1944 gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe përsëri pas Pleniumit të Brioneve të vitit 1966. Deduksioni është i qartë. Sipas avokatit nëse serbët u kanë bërë diçka shqiptarëve në segmente të caktuara kohore gjatë periudhës në fjalë, këta e kanë merituar¹⁸.

Më i hapur në qëndrime antishqiptare paraqitet profesori i Universitetit të Novi-Sadit, N.Gaçesha¹⁹. I profilizuar për problemet agrare dhe të kolonizimit në Jugosllavinë e shek. XX, për të cilat deri në vitin 1989 kishte botuar 3 monografi, N. Gaçesha e konsideron kolonizimin një detyrë që duhej zgjidhur "për t'u kujdesur për popullin e varfër", "për të shfrytëzuar në mënyrë më produktive tokat e shumta pjellore por të pa kultivuara, si edhe për të riserbizuar Kosovën serbe të shpopulluar nga serbët që nga mesi i shek.XVIII²⁰. Për N. Gaçeshin pushtimi i Kosovës më 1912 ishte "çlirim" dhe kolonizimi thjesht do të "rregullonte padrejtësinë historike". N. Gaçesha nuk kishte në vitet 80 as mungesën e informacionit, as mungesën e përgatitjes për të arsyetuar se nuk mund të shpëtohej nga varfëria "populli i varfër" serb duke varfëruar me dhunë një popull tjetër, se në Kosovë nuk bëhej fjalë për kriterin ekonomik të "reformës" agrare, se nuk mund të quhej çlirim okupimi i një territori të banuar në shumicë nga një popull i ndryshëm dhe se loja me "argumentin historik" ishte një pretekst politik i konsumuar, por për të edhe dokumentacioni zyrtar serb e jugosllav vlen të anashkalohej kur duheshin dhënë deduksione të paracaktuara. Profesor Gaçesha për të mbështetur konkluzionet e veta, për ta gjetur të drejtë, të domosdoshme e të dobishme, atë çka u bë në sferën agrare në Kosovë e në viset e tjera shqiptare në Serbi e Jugosllavi pas vitit 1912, e në mënyrë institucionale veçanërisht pas vitit 1918, gjen një vendim të 19.VII. 1935 për të bindur botën se Ministria e Bujqësisë e Mbretërisë Jugosllave e blinte tokën private për kolonizim²¹. Ndërkohë, një mori dokumentesh zyrtare dëshmojnë se gjatë gjithë periudhës 1918-1941, blerjet e pronave të shqiptarëve kanë qenë të papërfillshme, pa përmendur faktin se blerjet ishin fiktive në

¹⁷ Miloja Shçepanoviq, "Shpërngulja e serbëve dhe malazezëve (1878-1988)", *po aty*.

¹⁸ *Po aty*.

¹⁹ Nikolla Gaçesha, "Vendndodhja e Kosovës dhe Metohisë pas Luftës së Parë Botërore dhe reforma agrare", *po aty*.

²⁰ *Po aty*.

²¹ *Po aty*.

klimën antishqiptare të krijuar në Kosovën e pushtuar dhe të aneksuar, e sunduar nga Serbia apo Jugosllavia²².

Sipas N.Gaçeshës shumica e shqiptarëve, që u ankuan se u ishte marrë prona, "nuk ishin pronarë të vërtetë", prandaj këtyre uzurpatorëve ligji u bënte nder duke u lënë "minimumin e mjaftueshëm për jetesë". Përfundimisht sipas profesorit të Novi-Sadit, që iu besua të trajtonte temën e "reformës agrare" në Kosovë në periudhën midis dy Luftërave Botërore, në vend të ndonjë autori tjetër më kompetent si Millovan Obradović²³, fundi i kësaj ndërmarrjeje politike duhej konsideruar i "lumtur", sepse bujqit qenkeshin bënë pronarë, ish pronarët e prekur në tokën "e tepërt" qenkeshin kompensuar me të holla dhe gjatë kolonizimit qenkeshin mbajtur parasysh interesat e popullsisë lokale shqiptare, që "përfitoi" nga shteti sasi të mjaftueshme toke për të jetuar.

Pasi ka lëshuar tezat e sipërpërmendura, N.Gaçesha rreket të bindte ata që do të lexonin artikullin e tij, se intensiteti i paparë i procesit të kolonizimit në Kosovë, krahasuar me çdo rajon tjetër në Jugosllavi ku u krye ky proces, justifikohet "se toka [në Kosovë] qe më pjellore", ndërkohë që zbatues të autorizuar me autoritet suprem, si i plotfuqishmi për kolonizimin e të ashtuquajturave "Vise të Jugut", në fakt të trevave shqiptare e maqedone (sot terriore në Kosovë e Maqedoni), Gjorgje Krstiq²⁴, kanë theksuar hapur jo vetëm se ishte fjala për një politikë që synonte të thyhej kompaktësia e popullsisë shqiptare dhe të përmysej situata etnike në viset shqiptare, por edhe këshillonin e këmbëngulnin se si duhej intensifikuar dhuna mbi shqiptarët që të realizohej synimi sa më shpejt (Mendohej që serbizimi i Kosovës të realizohej për rreth 25 vjet- deklarata e N.Pashiqit).

Në funksion të synimeve të artikullit të tij dhe të frymës së gjithë vëllimit ku është botuar artikulli, sipas N. Gaçeshës në Kosovë për kolonizim "u shfrytëzuan djerrina të cilat u bonifikuan me përpjekje të mëdha", toka private u prek vetëm rrallë e në raste të domosdoshme dhe kundrejt kompensimit të njëjtë etj. etj.

²² Jusuf Osmani, *Lënda arkivore për kolonizimin dhe reformën agrare në Kosovë (1918-1941)*, Prishtinë: 1996; Gj. Kërstiq, *Kolonizacia...*; Milovan Obradović, *Agrarna reforma...*; Noel Malcolm, *Kosova - një histori e shkurtër*, Prishtinë: 1998; Michael Rouds, *Les albanais en Yougoslavie*, Paris: 1922; Jens Reuter, *Die Albanen in Yougoslavien*, Munchen: 1982; Marenglen Verli, *Reforma agrare kolonizuese në Kosovë, 1918-1941*, Bon-Tiranë: 1992; etj.

²³ Millovan Obradović, *Agrarna reforma i kolonizacija za Kosovu 1918-1941*, Prishtinë: 1981. M.Obradović në monografinë e sipërpërmendur, pavarësisht nga disa lëshime apo argumente të diskutueshme, është treguar objektiv në përcaktimin e karakterit të vërtetë të "reformës" në viset shqiptare. Mentor i studimit në fjalë ka qenë akademiku i njohur kosovar prof. Ali Hadri.

²⁴ Gjorgje Krstiq, *Kolonizacija na juzhnoj Srbiji*, Sarajevo: 1928.

Kushdo që e njeh problemin në fjalë, që ka pasur në duar sadopak dokumentet e administratës jugosllave të kohës, ose ka pasur rastin të lexojë qoftë edhe vetëm materiale si raporti i Gj. Krstiqit, ai i V. Çubrilloviqit apo monografinë e M. Obradoviqit, e ka të qartë fallsitetin e pohimeve të N.Gaçeshës. Toka private e shqiptarëve u prek masivisht në mënyrën më abuzive të mundshme dhe as për së afërmi nuk u kompensua, kurse djerrinat u bonifikuan në një masë të madhe me angazhimin e dhunshëm të shqiptarëve. Përfituesit kryesorë të reformës edhe midis sllavëve ishin pikërisht kolonët e ardhur në mesataren gati për familje 3:1, 3 ha për vendasit, kundrejt mbi 8 ha kolonët²⁵, madje përfituesit më të mëdhenj ishin ato kategori të popullsisë sllave si: çetnikët, nëpunësit etj., që dhe pse kishin lidhje me bujqësinë më pak se të tjerët, ose nuk kishin aspak, llogariteshin pjesë e strukturave që ushtronin dhunë mbi shqiptarët dhe privilegjoreshin sepse i shërbenin nënshtrimit dhe dëbimit të tyre nga Kosova e më gjerë.

Një mori tezash e pikëpamjesh tendencioze janë hedhur dhe mbrojtur nga historiografia serbe e jugosllave për problemet që shfaqen në periudhën e Luftës së Dytë Botërore në Kosovë e më gjerë dhe në Shqipëri²⁶. Edhe pse kjo periudhë është përplot çështje të diskutueshme edhe në historiografinë shqiptare të dy dekadave të fundit, që lidhen me qëndrimin e forcave të ndryshme politike vendase ndaj okupatorit dhe njëra-tjetrës, me rolin e lidhshëm të këtyre forcave, me kohën e fillimit me përmasat e rezistencës antifashiste, me përmasat e kolaboracionizmit me pushtuesit, me kontributin dhe humbjet njerëzore e materiale në kuadër të koalicionit antifashist etj., për historianët shqiptarë nuk ka dilema se shqiptarët dhanë kontribut në krahun e duhur²⁷. Historiografia shqiptare ka fiksuar dhe argumentuar tezat që provojnë pjesëmarrjen impresionuese të kombit shqiptar në lëvizjen antifashiste, mandej disavantazhet që solli në këtë angazhim copëtimi i dikurshëm i trevave shqiptare më 1913 dhe aneksimi e sundimi i më shumë se gjysmës së tyre nga

²⁵ M. Obradoviq, *vep. e përm.*; shih edhe M.Verli, *Reforma agrare...*; Po ai, *Kosova sfida shqiptare në historinë e një shekulli*, Tiranë: 2007 etj.

²⁶ Janko Pletevski, “Lufta Nacionalçlirimtare në Kosovë dhe çështja e antifashizmit”, në vëll. *Kosova past and...*; Spasoje Gjakoviq, “Partia Komuniste e Jugosllavisë në Luftën Nacionalçlirimtare dhe në revolucionin në Kosovë dhe Metohi”, *po aty*; Branko Petranoviq, “AVNOJ dhe Konferenca e Bujanit”, *po aty*; Milija Sçeapanoviq, “Shpërngulja e serbëve dhe malazezëve (1878-1988)”, *po aty*.

²⁷ *Historia e Shqipërisë*, vëll.III, Tiranë: 1984; *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll.IV, Tiranë: “Toena”, 2008; Xh.Gjeçovi, *Lufta nacionalçlirimtare në Shqipëri*, Tiranë: 1999; Po ai, *Pushtimi gjerman në Shqipëri (8 shtator 1943 – 29 nëntor 1944)*, Tiranë: 2004; Muharrem Dezhgiu, *Shqipëria në luftë (1939-1944)*, Tiranë: 2001; Po ai, *Shqipëria gjatë pushtimit Italian (1941-1943)*, Tiranë: 2005; Mentor Quku, *Qëndresa shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore*, vëll.I, II, Tiranë: 2006; Ali Hadri, *Lëvizja Nacionalçlirimtare në Kosovë 1941-1945*, Prishtinë: 1971, etj. etj.

shtetet ballkanike fqinje, përkatësisht mosbesimin në këto vise për bashkëpunim me lëvizjen serbe dhe greke të rezistencës, për pasojë vonesën dhe përmasat më të vogla të lëvizjes antifashiste shqiptare në Kosovë, Çamëri etj. dhe numrin më të shumtë të neutralëve, indiferentëve dhe kolaboracionistëve të pushtuesve në ato treva²⁸. Për historiografinë shqiptare po mbizotëron mendimi se për çështjen e së ardhmes në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore të gjithë krahët e grupimet politike shqiptare të kohës, pavarësisht nga koha dhe mënyra e paraqitjes së pikëpamjeve, u prononcuan për korrigjimin e arbitraritetit të padrejtë të Fuqive të Mëdha më 1913 dhe për bashkimin e Kosovës me shtetin shqiptar (Kujto deklaratat e Lidhjes së Dytë të Prizrenit dhe rezolucionin e Konferencës së Bujanit, përkatësisht tubime që zyrtarizuan qëndrimet e së djathtës dhe së majtës shqiptare në Kosovë, mandej pikëpamjet e dakorduara në Mbledhjen e Mukjes nga e majta dhe e djathta shqiptare etj.)²⁹

Historiografia serbe do të duhej të thyente klishtë, se PK Jugosllave ka bërë çmos të ngrejë në luftë kundër pushtuesit fashist shqiptarët “e prapambetur” dhe “reaksionarë”, se mbledhja e Bujanit nuk kishte tagër të ligjëronte vendime, ndaj ato që ajo mori dhe rezolucioni i Konferencës (Konferenca e Parë e Këshillit Nacionalçlirimtar për Kosovë e Rrafsh të Dukagjinit, e mbajtur më 31 dhjetor 1943, 1 dhe 2 janar 1944) “me të drejtë”, menjëherë u zhvlerësuan nga Tito etj.³⁰ Do të ishte e natyrshme që historianët serbë të pranonin se drejtuesit e PKJ nuk kishin interes të kishin një Kosovë më aktive në luftën antifashiste, çka mund të realizohej duke u prononcuar qartë për të ardhmen e saj pas luftës, sikurse e dëshironin shqiptarët shumicë atje dhe të humbisnin simpatinë e 5 milion serbëve të indoktrinuar me tezën e Kosovës “serbe”, madje “djep” të Serbisë. Mandej do të ishte e natyrshme që historiografia serbe të rishikojë me realizëm rolin e PKJ në lëvizjen komuniste e antifashiste në Shqipëri dhe përgjithësisht në ngjarjet politike në Shqipëri në vitet 1941-1944, deri sot të dimensionuara në mënyrë jo reale. Por diçka e tillë nuk është bërë dhe ndoshta do të duhet ende kohë për të reflektuar.

Diktati i politikës së ditës e vuri në pozitë edhe më absurde historiografinë serbe e jugosllave për problemet e historisë së Kosovës në periudhën e Pasluftës së Dytë Botërore. Me synimin për të dënuar me çdo kusht idenë e krijimit të Republikës së Kosovës dhe bartësit e saj, historianë dhe publicistë të shumtë u angazhuan të paraqiten në sinkron me qëndrimet zyrtare të politikës

²⁸ *Po aty*; Shih gjithashtu: Ali Hadri, *Lëvizja Nacionalçlirimtare në Kosovë*, Prishtinë 1973; M. Verli, *Kosova sfida shqiptare ...*; etj.

²⁹ *Po aty*; Shih edhe: *Fadil Hoxha, një jetë në shërbim të atdheut*, Prishtinë: 2007; *Konferenca e Bujanit*, Tiranë: 1999; Lefter Nasi, *Ripushtimi i Kosovës*, Tiranë: 1994; Muhamet Shatri, *Kosova në Luftën e Dytë Ballkanike*, Prishtinë: 1997; etj.

³⁰ M.Obradoviq, *vep. e përm.*; shih edhe M.Verli, *Reforma agrare kolonizuese ...*; po ai, *Kosova sfida shqiptare... etj.*

së Beogradit. Autorë, si: R.Rajoviq, R.Markoviq, K.Mihajllloviq, M.Macura, V.Tadiq etj., janë rekur në këtë kuadër të argumentojnë se Kosova pati më shumë se ç'i takonte autonomi në sistemin kushtetues jugosllav, se kjo krahinë autonome e Serbisë nuk mund të bëhej republikë, se zhvillimi i saj ekonomiko-kulturor etj. ishte maksimal dhe, nëse në rrafshin krahasues apo relativ ajo e kishte thelluar diferencën me treguesit zhvillimorë të Jugosllavisë, ose edhe të secilës republikë të saj, kjo kishte ndodhur për shkak të vetë shqiptarëve³¹. Ndër problemet negative të shqiptarëve, autorët në fjalë numërojnë prapambetjen dhe shtimin e pakontrolluar demografik, një varg problemesh që lidhen me keqpërdorimin e investimeve etj.

Në pamundësi për të trajtuar të gjithë gamën e problemeve të Pasluftës së Dytë Botërore, në vazhdim të kësaj kumtese fokusimi do të bëhet vetëm në çështjen aq të përfolur, ndryshe të zhvillimit ekonomik të Kosovës. Profesori nga Beogradi K.Mihajllloviq duke trajtuar ecurinë e ekonomisë së Kosovës për vitet 1945-1987, pranon se aty konstatohej një mbipopullim në sektorin e bujqësisë, se diferencat me ekonominë e Federatës u thelluan, se, edhe pse baza e nisjes ishte e ulët, çka jepte shanse për zhvillim me ritme të shpejta, në fakt rritja vjetore e produktit shoqëror në periudhën 1948-1980 ishte më e vogël se mesatarja jugosllave e këtij treguesi (5,7% ndaj 6%)³². Pranohet gjithashtu se struktura e investimeve kishte qenë e papërshtatshme, çka nuk i përgjigjej as nevojave të Kosovës, as rritjes më të mirë të të ardhurave dhe as zënies më të madhe me punë të popullsisë aktive. Autori i sipërpërmendur pranon gjithashtu se pas luftës Jugosllavia, duke aktivizuar burimet natyrore të Kosovës, zgjidhte probleme të zhvillimit të vet ekonomik, madje, ajo me çmimet diskriminuese për lëndët e para që favorizuan republikat e zhvilluara, përcaktoi efektivitetin e ulët të investimeve dhe rendimentin e ulët të punës në Kosovë. K. Mihajllloviq pranon edhe se kreditimi i ekonomisë kosovare nga Fondi Federativ, për shkak të inflacionit, nuk siguroi për të aq sa pritej³³.

³¹ Radoshin Rajoviq, "Zhvillimi kushtetues nga autonomia deri në reformën e vitit 1989", në vëll. *Kosova, past ...*; R. Rajoviq (1924) ishte lektor në Universitet dhe ish-anëtar i Gjykatës Kushtetuese. Ratko Markoviq, "Përse Kosova nuk mund të bëhet republikë", *po aty*. R. Markoviq (1944) ishte profesor në Fakultetin Juridik në Universitetin e Beogradit; Kosta Mihajllloviq, "Zhvillimi ekonomik i Kosovës", *po aty*. Dr. K.Mihajllloviq (1917) ishte profesor në pension në Fakultetin e Ekonomisë në Universitetin e Beogradit, si dhe anëtar i Akademisë së Arteve e Shkencave të Serbisë. Ndër librat e botuar të tij bën pjesë edhe monografia: *Zhvillimi i ekonomisë së Kosmetit (1958-1961)*, (1962); Milosh Macura, "Problemi i lindshmërisë në Kosovë", *po aty*; Veljo Tadiq, "Arsimi dhe transformimi kulturor i Kosovës", *po aty*. V.Tadiq (1926) ishte profesor i letërsisë dhe gazetar në pension.

³² K. Mihajllloviq, "Zhvillimi ekonomik i ...", *po aty*.

³³ *Po aty*.

Pavarësisht nga pohimet e mësipërme, profesori i ekonomisë nga Beogradi është përpjekur të justifikojë pse struktura e investimeve në Kosovë ishte e papërshtatshme, apo pse Kosovës iu imponuan çmime diskriminuese për produktet e ekonomisë së saj. Ai e ka të vështirë të pohojë se ishte diktati nga lart që përcaktonte “strukturën e papërshtatshme të investimeve”, kurse çmimet e ulëta, të imponuara deri në nivele mjaft nën kuotat respektive të tregut botëror, edhe pse kishin të bënin me ruajtjen e aftësive konkurruese të ekonomisë jugosllave në tregun e huaj, çonin në privilegjimin e republikave të zhvilluara, në dëm të ekonomisë kosovare³⁴. Sipas profesorit Mihajloviq, Kosova e paska pasur vetë fajin për strukturën e papërshtatshme të ekonomisë, sepse pas viteve 50, ajo nuk kishte më administrim të centralizuar. Por është fakt se, në çdo kohë, për shkak të varësisë së ekonomisë së Kosovës nga investitori i huaj, qoftë edhe nga Fondi Federativ Jugosllav dhe nga orientimi i deriatëhershëm i kësaj ekonomie, nuk mund të mos kushtëzohej në vazhdimësi një orientim pak a shumë i ngjashëm. Efektivitetin e ulët të investimeve K. Mihajloviq dhe jo vetëm ai, e arsyetojnë edhe me disiplinën e pamjaftueshme në punë, drejtimin e dobët, zvarritjen e ndërtimeve, ritmin e ulët të përshtatjes, etj., defekte që në fakt, nuk ishin specifike vetëm për Kosovën, ndaj edhe s’mund të përbënin faktor determinues për prapambetjen në ekonominë e saj³⁵. Nga ana tjetër, ai anashkalon shtimin e papunësisë apo nuk përmend rënien e dukshme të standardit të jetesës për periudhën 1979-1987, që nuk lidhej vetëm me stanacionin që po kaplonte përgjithësisht ekonominë jugosllave, por edhe me goditjet në ekonomi për motive politike, sidomos pas ngjarjeve të vitit 1981³⁶.

Rritjen e diferencave midis ekonomisë kosovare dhe ekonomisë së çdo republike, ose mesatares federative K. Mihajloviqi ia faturon mungesës së strategjisë për zhvillimin e rajoneve të prapambetura, ndër të cilat në krye ishte Kosova, dhe të “metës” së shqiptarëve për lindjet e pakontrolluara dhe shtimin galopant të popullsisë së Kosovës, që sipas tij, “ndikoi në mënyrë vendimtare në prapambetjen” e vendit. Duke qenë kontradiktor në argumente dhe duke iu shmangur pasqyrimin të politikës jugosllave të investimeve në Kosovë, qoftë në sasi, qoftë në strukturë për profilizimin e ekonomisë si burim lëndësh të para dhe produktesh pa rentabilitet, ose në drejtim të kushteve të likuiditetit dhe pasojës që sillnin indirekt çmimet diskriminuese, ky profesor, shkakun e

³⁴ M. Roux, *Les albanais....*; J. Renter, *Die Albanien....*, N. Malcolm, *Kosova....*; Musa Limani, *Politika ekonomike*, Prishtinë: 1994; M. Verli, *Ekonomia e Kosovës në vargonjtë e politikës jugosllave 1945-1990*, Tiranë: 2000; etj.

³⁵ K. Mihajloviq, “Zhvillimi ekonomik i”, *Kosova past*

³⁶ M. Roux, *Les albanais....*; J. Renter, *Die Albanien....*, N. Malcolm, *Kosova....*; Musa Limani, *Politika ekonomike*, Prishtinë: 1994; M. Verli, *Ekonomia e Kosovës në vargonjtë e politikës jugosllave 1945-1990*, Tiranë: 2000; etj.

prapambetjes së madhe ekonomike të Kosovës, e kërkon edhe në “rendimentin relativisht të ulët të investimeve”³⁷.

Profesori i sipërpërmendur por edhe teoricienë të tjerë të ekonomisë, përpiqen kështu të fajësojnë Kosovën për prapambetjen permanente ose zhvillimin e pamjaftueshëm, në periudhën e Pasluftës së Dytë Botërore, me gjithë “përpjekjet shumë të mëdha materiale [të Jugosllavisë] për ta nxjerrë Kosovën nga prapambetja ekonomike”. Ndërkohë Titoja vetë pat deklaruar se ajo çka i jepej Kosovës, nuk duhej konsideruar si “ndihmë”.

“Politika e zhvillimit ..., konkludon K.Mihajllloviq, e rajoneve të pazhvilluara nuk e ka kufizuar autonominë e Kosovës, që kjo të zgjedhë strategjinë e vet të zhvillimit”. Është paradoksale të mendosh se Kosova parapëlqeu të zhvillonte industrinë bazike, jo rentabël, por teza të kësaj natyre janë hedhur për të qarkulluar idenë se “autonomia bart rreziqe të mëdha” në rast se nuk hartohet një politikë e drejtë për zhvillimin, që do të thotë se autonomia e paska dëmtuar ekonominë e Kosovës. Nënteksti është i qartë: Kosova duhej të hiqte dorë nga autonomia nëse “donte të zhvillohej”³⁸.

Libri “Kosova - e kaluara dhe tashmja” u përgatit dhe u botua me autorë të seleksionuar me kujdes, jo rastësisht në fund të viteve 80. Ky vëllim duhet të përmbante tezat më agresive antishqiptare të historiografisë serbe-jugosllave dhe të ndonjë sferë tjetër të shkencave natyrore, për justifikimin e ofensivës së filluar që në vitin 1988 për rrënimin dhe asgjësimin e autonomisë së Kosovës. Prandaj aty u publikuan edhe suksese edhe probleme të sferës së arsimit³⁹, edhe artikuj për të ashtuquajturat “organizata shoviniste dhe separatiste në Kosovë dhe lidhjen e tyre me qendrat e huaja”⁴⁰, edhe të dhëna policeske për “separatizmin antijugosllav në “Shqipërinë mëmë”⁴¹, edhe akuza të stisura kundër shqiptarëve për veprime “në vazhdimësi për shqiptarizimin e Kosovës”⁴²,

³⁷K. Mihajllloviq, “Zhvillimi ekonomik i ...”, *Kosova past*

³⁸ *Po aty*.

³⁹ V.Tadiq, “Arsimi dhe transformimi ...”, *po aty*.

⁴⁰ Sinan Hasani, “Organizatata shoviniste dhe separatiste në Kosovë dhe lidhja e tyre me qendrat e huaja”, *po aty*. S.Hasani (1922) ka qenë politikan kosovar me funksione të larta shtetërore. Kryetar i presidencës rotative të RSF Jugosllavisë në periudhën maj 1986-maj 1987. Autor i disa artikujve që trajtojnë probleme shoqërore-politike të Kosovës dhe i librit “Kosova-e vërteta dhe gabimet”.

⁴¹ Bllagoje Nikoliq, “Separatizmi antijugosllav i mbështetur në “Shqipërinë mëmë”, *po aty*. B.Nikoliq (1936), jurist, avokat, zëvendëssekretar në Sekretariatit Federativ të Drejtësisë dhe Administrimit.

⁴² Milosh Miloviq, “Vazhdimësi në shqiptarizimin e Kosovës”, *po aty*. M. Miloviq (1916) ka qenë gazetar, ish-redaktor i revistës NIN të Beogradit dhe lektor në degën e gazetarisë në Fakultetin e Shkencave Politike në Universitetin e Beogradit. Me sa duket u zgjodh për bashkautor në vëllimin përmbledhës pas botimit të librit *Kush kërkoi republikë të Kosovës nga viti 1945-1985* (1987).

edhe teori e bllofe për barazinë nacionale në Kosovë⁴³, edhe falsifikime e politizime lidhur me motivet e shpërnguljeve të serbëve dhe malazezëve nga Kosova në vitet '60-'70⁴⁴.

Në vëllimin në fjalë nuk mund të lihej pa u atakuar edhe Shqipëria, dhe kjo u bë kryesisht në një kapitull të veçantë të titulluar "Kosova dhe marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare", në të cilin u grupuan katër artikuj⁴⁵.

Së fundi, nën titullin "Kosova e patjetërsueshme" dhe nëntitullin "Programi jugosllav për Kosovën"⁴⁶, Beogradi tregoi thelbin e librit "Kosova, e kaluara dhe e tashmja", si dhe kriteret e rekrutimit të autorëve që do të shkruanin këtë libër. Historiografia serbe pas 20 vitesh, përgjithësisht, nuk ka lëvizur nga tezat e vjetra. Gjithsesi, ajo ka shansin të reflektojë në dy drejtime, të mos lejojë që të përfaqësohet dhe perifrazohet nga autorë me profilizim shkencor të diskutueshëm dhe, kryesorja, të rishikojë me objektivitet e motive thjesht shkencore, tezat e qëndrimet e pozicionuara nën kornizën e politikës, madje të segmenteve më të errëta apo më ekstreme të politikës nacionaliste serbe.

E njëjta këshillë do t'i adresohet edhe kujtdo tjetër që në trajtimin e historisë së popullit shqiptar nuk është distancuar ende nga produktet e falsifikuara që ndeshen në historiografinë serbe. Objektiviteti shkencor në trajtimin e historisë së popullit shqiptar, por edhe të popullit serb, maqedon etj. është jo vetëm thjesht një obligim në të mirë të së vërtetës shkencore. Historia e shkruar me vërtetësi përcjell mesazhet e vërteta, që janë në të mirë të gjithkujt, sepse kontribuon për njohjen e miqësinë e popujve e për rrjedhim në stabilitetin, zhvillimin dhe prosperitetin e përgjithshëm.

⁴³ Milosh Sekulović, "Barazia nacionale dhe krijimi i një shumice në Kosovë", *po aty*. M.Sekulović (1937), është jurist, avokat dhe më 1989 kryetar i Këshillit Punëdrejtues të "Centropromit". Shkruante herë pas here në organet periodike.

⁴⁴ Ruzha Petroviq, Marina Blagojeviq, "Shpërngulja e serbëve dhe malazezëve nga Kosova e Metohija", *po aty*. R.Petroviq (1928) profesor sociologjie në Fakultetin e Filozofisë në Universitetin e Beogradit. Autor i disa veprave sociologjike. M.Blagojeviq (1958), sociologe në të njëjtin Fakultet.

⁴⁵ Milorad Komatina, "Marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare midis viteve 1945-1989", *po aty*. M.Komatina (1924) ambasador në pension. Këshilltar i ambasadës në Shqipëri në vitet 1971-1974. Gavro Peraziq, "E drejta ndërkombëtare dhe pozita e pakicave kombëtare në Jugosllavi dhe në Shqipëri", *po aty*. G.Peraziq (1923), profesor në Fakultetin Juridik në Universitetin e Titogradit. Autor i një varg botimesh; Miluytin Milenković, "Propaganda shqiptare kundër Jugosllavisë nga taktikat te absurditeti", *po aty*. M.Milenković (1925), komentator për çështjet e Jashtme në Radio-Beograd, publicist, ish-drejtor i Radio-Beogradit.

⁴⁶ Branko Kostiq, "Programi jugosllav për Kosovën", *po aty*. B.Kostiq (1924) avokat, kryetar i Komisionit Federativ që ndiqte zbatimin e programit jugosllav në Kosovë.